



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:069797

Datë: 07.07.2021

Numri i dokumentit: 01971099

**P. nr.192/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. B. nga lagjja . . . K Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën. par. 1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti-Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr. 450/21 të datës. 12.04.2021, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.07.07.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP në Gjakovë PP/II.nr. 450/21 dt. 12.04.2021, dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

Të akuzuarit:

**B. B. ,nga Gjakova Rr”**. . .“ **lagjja . . .**, nga i ati Q., dhe nëna Gj. e gjinisë K. , data e lindjes . . . , në Gjakovë , ka të kryer shkollën e mesme , vozitës , i gjendjes se dobët ekonomike, me nr.personal: . . . shqiptar, Shtetas i R. Kosovës,.

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

**-me datë 21.02.2021, rreth orës 21.00, në lagjen . . .K Gjakovë, saktësisht tek supermarketi “D.”**, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit D. D. , në atë mënyrë që natën kritike pasi të njëjtit kishin pasur një mosmarrëveshje të atë çastshme në komunikacion ku i dëmtuari i drejtohet të pandehurit me fjalët *“pse nuk ndez treguesin e drejtimin se për pak isha duke e dëmtuar ndërruesin e shpejtësisë”*, të njëjtit më pas fjalosen mes veti dhe i dëmtuari nxjerr një shkop druri nga vetura , e pas këtij veprim i pandehuri revoltohet dhe e godet të dëmtuarin disa here me grushte në anën e majtë të fytyrës derisa ndërhyjnë disa kalimtar dhe e largojnë të pandehurin , me ç ‘rast te dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të pakohshme për shëndetin, të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko ligjore te Dr. M. G. me nr. ref. GJA-170/21 të dt. 28.03.2021

**- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.1 nen par.  
1.4 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata konform nenet 4,17,38,40, 43,69 dhe neni 185 par.1 nen par 1.4 të KPRK-së, si dhe neni 495 te KPPK-së, të akuzuarin B. B. e

**G J Y K O N**

Me dënimin me gjobë në shumë prej **200 (dyqind) euro**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

I dëmtuari D. D. nga Tropoja R. e Shqipërisë , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas neni 43 par.4 të KPRK-së, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10(dhjet) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20,00 € (njëzet) euro**.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shumën prej 20,00 € , ne emër të ekspertizës mjeko ligjore si dhe shumën prej 30 euro në emër të paushallit gjyqësor ,në afat prej 15 ditëve ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë në.

**A r s y e t i m**

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP./II nr. 450/21 të dt. 12.04.2021 , ndaj të akuzuarit B. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nen par. 1.4 të KPRK-së.

Komfor neni 493 te KPPK-së, PTH në Gjakovë, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së neni 185 par. 1 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në 3(tri) vite ..

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor neni 495 te KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e neni 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH-së në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit, dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi penal me nr. të rastit 2021-EA-270 dt. 10.03.2021
- Raporti i oficerit D. P. dt. 21.02.2021
- Akt ekspektimi mjeko ligjor i Dr. M. G. me nr. Ref. Gja-170/21 dt.28.03.2021
- Raporti mjekësor me nr. 2158 dt.21.02.2021 lëshuar nga spitali “. . .” Gjakovë për të dëmtuarin D. D.

- Deklarata e të pandehurit B. B. të dhënë në polici me dt.03.03.2021;
- Deklarata e të dëmtuarit D. D. të dhënë në polici me dt.21.02.2021;
- Deklarata e dëshmitareve A. Z. dhe J. K. të dhënë në polici me dt.06.03.2021;
- Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 38 të KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet në shumë prej 20 .00 € në emër të ekspertizës mjeko ligjore në shumë prej 30 euro në emër të paushallit gjyqësor, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.,

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**P.nr. 192/21 të dt. 07.07.2021**

**Sekretarja Juridike:**  
**Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja**  
**Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtares të kësaj Gjykate . Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.